

BULETINI CENS 2020

NR. 2 | DHJETOR 2018 |



Buletini Informues Cens 2020 shërben si pasqyrë e aktiviteteve kryesore që INSTAT ka ndërmarrë dhe do të ndërmarrë deri në përfundim të këtij projekti. Ai do të shpërndahet me një frekuencë tremujore. Pas publikimit të numrit të parë në Nëntor 2018, në numrin e dytë të buletinit do të paraqiten aktivitetet e zhvilluara deri tani dhe çfarë pritet të ndodhë gjatë vitit 2019.

CENSI I POPULLSISË DHE BANESAVE 2020

Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) ka planifikuar të kryejë Cens-in e ardhshëm të Popullsisë dhe Banesave në vitin 2020. Cens-i i Popullsisë dhe Banesave 2020 do të ndjekë metodën e numërimit të drejtpërdrejtë universale bazuar në operacionet në terren me përpilimin e pyetësorëve nga anketuesit, duke përdorur metoda të reja për mbledhjen e të dhënave.

Kontaktet:

Delina Ibrahimaj, Drejtore e Përgjithshme e INSTAT
DIbrahimaj@instat.gov.al

Alban Çela, Drejtues i Njësisë IPA
ACela@instat.gov.al

Gladiola Baja, Përgjegjëse e Sektorit të Koordinimit të Projekteve
GBaja@instat.gov.al

Klajd Shuka, Përgjegjës për Zbatimin Operacional të Projektit
KShuka@instat.gov.al

Helda Mitre, Përgjegjës për Zbatimin Teknik të Projektit
HMitre@instat.gov.al

Altin Xhikneli, Përgjegjës për Komunikimin
AXhikneli@instat.gov.al

Instituti i Statistikave
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodë Postar 1017

Cens2020@instat.gov.al
www.instat.gov.al
Tel: +355 4 2222 411
Faks: +355 4 2222 411

PËRMBAJTJA

Cens-i Popullsisë dhe Banesave 2020

- Drafti Final i Pyetësorit
- Ecuria e planit të aktiviteteve
- VKM për Projektligjin e Cens 2020
- Marrëveshja financiare për mbështetjen e aktiviteteve të Cens 2020
- Nënshkruhet kontrata e grantit
- Projekti SALSTAT
- INSTAT merr mbështetjen e Delegacionit Evropian
- UNFPA mbështet INSTAT

Tryezat konsultative me grupet e interesit:

- Takim me përfaqësuesit e Komuniteteve Fetare
- Takim me përfaqësuesit e Personave me Aftësi të Kufizuar
- Takim me përfaqësuesit e Pakicave Kombëtare dhe grupeve Etno-Kulturore


Drafti Final i Pyetësorit të Cens 2020

Pas përfundimit të pesë tryezave konsultative të organizuara gjatë vitit 2018, qëllimi i të cilave ishte diskutimi mbi përbajtjen e pyetësorit të Cens 2020, u mbledhën të gjitha komentet dhe sugjerimet nga grupet e interesit.

Këto sugjerime dhe komente u analizuan nëse ishin në përputhje me rekomandimet e më pas u reflektuan në përbajtjen e pyetësorit.

Në datën 28 dhjetor 2018, në websitin e INSTAT do të publikohet drafti final i pyetësorit të Cens 2020.

Ecuria e planit të aktiviteteve



INSTAT ka mbërritur në këtë fazë

Miratohet VKM-ja e Projektligjit “Për Cens-in e Popullsisë dhe të Banesave”

Në datën 5 Dhjetor 2018 është miratuar VKM-ja për propozimin e Projektligjit “Për Cens-in e Popullsisë dhe të Banesave”.

Projektligji është depozituar nga Këshilli Ministrave në datën 07 dhjetor 2018 në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe është në procedurë për miratimin e saj.

Ky ligj rregullon organizimin dhe realizimin e Cens-it të Popullsisë dhe të Banesave në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 3, të ligjit nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”.

Organizimi i tri tryezave konsultative me grupet e interesit:



Në datë 12 Nëntor 2018, INSTAT organizoi takim me përfaqësuesit e komuniteteve fetare në vend për të diskutuar rreth draft-pyetësorit të Cens-it të Popullsisë dhe Banesave 2020.

Gjatë këtij takimi, pas diskutimeve të gjata, u arrit në përfundimin se pyetja e parashtruar në pyetësorin e Cens-it duhet të ketë fusha të parapërcaktuara sipas VKM-së dhe u propozua që të shtohet në pyetësor një alternativë tjetër për personat që nuk përfshihen në grupet e parashtruara.

Në datë 19 Nëntor 2018, INSTAT zhvilloi takim me përfaqësuesit e Personave me Aftësi të Kufizuar (PAK).

Në takim u parashtruan shumë sugjerime dhe kërkesa, sa i takon riformulimit të pyetjeve në pyetësor, thjeshtëzimit të termave, trajnim të mirë të anketuesve për termat, shtimin e pyetjeve të tjera.

Në fund të takimit u konkludua se sugjerimet e përfaqësuesve të Personave me Aftësi të Kufizuar do të reflektohen në përmbajtjen e pyetësorit, duke u bazuar gjithashtu në rekomandimet e Eurostat dhe Kombeve të Bashkuara.



INSTAT organizoi më 4 Dhjetor 2018 tryezën konsultative me përfaqësuesit e Pakicave Kombëtare dhe grupeve Etno-Kulturore. Ky takim nisi me aprovimin nga të gjithë përfaqësuesit për pyetjen e katërt të pyetësorit; "A mendoni se duhet të jetë pjesë e pyetësorit të Cens 2020, pyetja për përkatësinë Etno-Kulturor".

Disa nga temat që u propozuan ishin unifikimi i terminologjisë Etno-Kulturor ose Pakicë Kombëtare, përkufizimin e grupeve etnike të përcaktuara me ligj, pjesë e numëruesve të jenë edhe anëtarë të pakicave kombëtare etj.

Në përfundim të takimit u konkludua se sugjerimet e përfaqësuesve do të reflektohen, duke u bazuar në rekomandimet e Eurostat dhe Kombeve të Bashkuara.

Marrëveshje Financiare për mbështetjen e zbatimit të aktiviteteve të Cens 2020

Në kuadër të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, për programin vjetor kombëtar IPA 2014, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Parazgjerimit (IPA II), me Vendim Nr. 716, datë 05.12.2018 është miratuar në parim ndryshimi nr. 3 i marrëveshjes financiare i cili alokon një fond prej 4,8 milionë Euro për projektin "Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Cens-it të Popullsisë dhe Banesave 2020".

Nënshkruhet kontrata e grantit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë (CFCU) dhe INSTAT

Në datë 11.12.2018 është firmosur marrëveshja e grantit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë (CFCU) dhe Institutit të Statistikave (INSTAT). Qëllimi i kësaj kontrate është financimi në formën e një granti me menaxhim indirekt nga autoriteti kontraktues për zbatimin e projektit "Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Cens-it të Popullsisë dhe Banesave 2020 në Shqipëri".

Gjatë muajit dhjetor ka filluar procedura e vlerësimit për tenderin "Mbështetje për zbatimin e Cens-it të Popullsisë dhe Banesave 2020 në Shqipëri" me qëllim përzgjedhjen e kompanisë që do të zbatojë kontratën e shërbimit.

INSTAT, FSO dhe SDC nënshkruajnë marrëveshjen për zbatimin e projektit SALSTAT

Në kuadër të programit “Bashki të Forta”, financuar nga Zyra e Bashkëpunimit Zviceran për Zhvillim, në datën 19 dhjetor 2018 është nënshkruar marrëveshja ndërmjet INSTAT, FSO dhe SDC për fazën e zbatimit të projektit “Statistika të Forta Vendore Shqiptare - SALSTAT”, e cila përfshin periudhën 01.09.2018 deri më 31.08.2022.

Qëllimi i këtij projekti është të mbështesë INSTAT në ndërtimin dhe forcimin e sistemit statistikor në Shqipëri, duke siguruar një sistem statistikor të qëndrueshëm të të dhënave të rëndësishme për anëtarësimin e vendit në Bashkimit Evropian, si dhe të ndërtojë komponentët kryesorë të regjistrave bazë për qëllime administrative dhe statistikore, në veçanti në nivel lokal dhe rajonal.

Gjithashtu, ky projekt do të mbështesë INSTAT në kryerjen e disa aktiviteteve të Cens-it 2020 lidhur me përditësimin e hartave, duke siguruar ekspertizë, ngritje kapacitetesh dhe blerje pajisjesh IT.

Delegacioni Evropian mbështet INSTAT për vlerësimin dhe monitorimin e zbatimit të aktiviteteve të Cens-it të Popullsisë dhe Banesave

Në kuadër të menaxhimit të kontratës së grantit, të nënshkruar ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë (CFCU) dhe Institutit të Statistikave (INSTAT), Delegacioni Evropian në Shqipëri do të sigurojë asistencë mbi vlerësimin dhe monitorimin e zbatimit të aktiviteteve të Cens-it të Popullsisë dhe Banesave me dy ekspertë të cilët do të mbështesin:

- Njësinë e Menaxhimit të Cens-it në përgatitjen e procedurave të prokurimit dhe raporteve financiare
- Sigurimin e monitorimit në mënyrë të vazhdueshme të procedurave dhe raportimit

INSTAT merr mbështetjen nga UNFPA

Në kuadër të Cens-it 2020, UNFPA është angazhuar të mbështesë kryerjen e aktiviteteve lidhur me metodologjinë e Cens-it 2020, specifiku asistencë teknike për finalizimin e pyetësorit, si dhe përgatitjen e materialeve ndihmëse.

Aktivitetet e realizuara dhe që priten të zhvillohen në vijim:

- **Aktivitetet në kuadër të “Përditësimin të hartave në terren” nga Njësia e Gjeoinformacionit për Cens 2020:**
 - ✓ Është realizuar planifikimi i shpërndarjes së stafit me kontratë sipas zonave në të gjithë territorin e vendit sipas 61 bashkive
 - ✓ Ka përfunduar specifikimi i kriterëve për përzgjedhjen e stafit me kontratë dhe pritet finalizimi i pyetësorit. Për realizimin e këtij aktiviteti do të rekrutohen anketues terreni dhe kontrollorë GIS në zyrë
 - ✓ Është në proces përgatitja e udhëzuesve dhe manualëve të punës
 - ✓ Në fillim të vitit 2019 do të kryhet organizimi dhe realizimi i trajnimit të anketuesve dhe kontrollorëve
- Në Janar 2019, me fondet e Buxhetit të Shtetit do të fillojë procesi i prokurimit të tabletave për Pilotin e Cens-it, i cili do të zhvillohet në tetor 2019
- Gjatë vitit 2019 do të kryhet vlerësimi, kontraktimi dhe zbatimi i kontratës së shërbimit për asistencën teknike
- Gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2019 do të realizohet rekrutimi i punonjësve për zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve, si dhe përditësimin e hartave të zonave të Cens-it 2019
- Për të nxitur sensibilizimin e pjesëmarrjes në Cens 2020, në fillim të vitit 2019 do të zhvillohen dy tryeza të rrumbullakëta, një me grupet parlamentare dhe një me përfaqësues të mediave